



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program Financa (2022/2023)

Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Kodi	FIN-120
Titulli	Magjistër i shkencave ekonomike / Drejtimi: Financa
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-1327/1
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	04.05.2022

Përshkrimi i programit

Qëllimet e programit janë:

- Ngritja e nivelit të administrimit dhe të udhëheqjes së ndërmarrjes dhe zhvillimi i menaxhmentit bashkëkohor;
- Aftësimi dhe ndërtimi i menaxherëve të profilit bashkëkohor: sipërmarrës, të gatshëm të ndërmarrin aksione, por edhe rreziqe të cilat ndërlidhen me çdo iniciativë, fleksibile, persona të vendosur dhe të guximshëm;
- Arsimimi i menaxherëve me kualifikim të lartë dhe profesionistë me aftësi lideri dhe dëshira për t'u ballafaquar me sfidat e mileniumit të ri;
- Krijimi i menaxherëve me pikëpamje të reja dhe me mënyra, po ashtu të reja, të të menduarit, zhvillimi i aftësive për parashikimin e të ardhmes dhe pranimi i sfidave dhe mundësive, të cilat i ofron biznesi në shekullin 21.

Karriera

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:

- Të punojnë në mënyrë individuale dhe në grupe për hulumtimin e formave më përkatëse për plotësimin e nevojave të popullatës,
- T'i elaborojnë dallimet dhe nevojat e bashkësisë, nga aspekti shkencor dhe profesional.
- Të marrin pjesë aktive në ndërtimin e politikës makroekonomike dhe mikroekonomike.
- Të informohen dhe të kontribuojnë në elaboratet shkencore dhe profesionale.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Llogaritja e agregatëve themelorë makroekonomikë dhe analiza kritike e politikave aktuale makroekonomike.

Dhënia e mendimit kritik për politikat zhvillimore dhe aplikimi i tyre në ekonominë kombëtare.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

Aftësi për të diagnostifikuar zhvillimet aktuale të tregut, parashikimi i tendencave të këtyre zhvillimeve dhe analiza e efekteve dhe e masave të politikës ekonomike mbi lëvizjet e tregut.

Aftësitë për të vlerësuar

Të jenë në gjendje të përfshihen në pozita udhëheqëse në organizatat fitimprurëse dhe jofitimprurëse në vend dhe nëpër botë.

Analiza e proceseve të përgjithshme të zhvillimit ekonomik në botë dhe veçanërisht në proceset e tranzicionit, rajonalizimit dhe globalizimit të trendeve botërore ekonomike.

Aftësitë e komunikimit

Mundësia e zhvillimit të aftësive personale, komunikimit, hulumtimit dhe fitimi i aftësive të tjera të rëndësishme të cilat janë të nevojshme për punësim.

Mundësia që studentët të angazhohen në mënyrë aktive në ligjërata dhe të kryejnë hulumtime të pavarura në të gjitha fushat e biznesit dhe ekonomisë.

Aftësitë e të mësuarit

Zhvillimi i konceptit i të menduarit kritik të studentëve.

Mundësia e përvetësimit të aftësive hulumtuese dhe përvojës për menaxhim, marketing dhe financa publike, në organizatat private dhe jofitimprurëse.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [CM233] [3.0 SETK] **Tatimet dhe vendimmarrja**
- [CM232] [6.0 SETK] **Raportimi financiar dhe vendimmarrja**
- [CM234] [3.0 SETK] **Bankieria tregtare dhe e korporatave**
- [CM187] [6.0 SETK] **Ekonometria**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 2

- [CM237] [3.0 SETK] **Kontabiliteti i aplikuar**
- [CM200] [3.0 SETK] **Revizioni**
- [CM236] [6.0 SETK] **Menaxhimi i investimeve**
- [CM235] [6.0 SETK] **Anaitikë biznesi dhe modelim**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 3

- [CMBA01] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [CMBA19] [6.0 SETK] **Menaxhimi i projekteve**
- [CM196] [6.0 SETK] **Financa ndërkombëtare**
- [EM554] [6.0 SETK] **Ekonomia e aplikuar**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 4

- [BE-THESIS-120] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Tatimet dhe vendimmarrja**

Lënda thekson qasjen e vendimmarrjes, prezanton të gjitha temat e taksave dhe mbulon tatimin themelor të të gjithë tatimpaguesve: individë, korporata, ortakëri dhe subjekte fiduciare, duke theksuar ekuilibrin midis koncepteve dhe detajeve. Lënda, përmban detaje të mjaftueshme teknike për të siguruar një bazë për praktikën e ardhshme në taksimin dhe shërbimet e këshillimit, ndërsa nuk e ngarkon studentin me detaje që rrallë hasen.

- **Raportimi financiar dhe vendimmarrja**

Përmes informacionit të pasqyrave kryesore financiare synohet, që organet e menaxhimit në kompani, të jenë në kohë të pajisur me informacion cilësor në funksion të miratimit të vendimeve të drejta biznesore. Informacioni cilësor përmes pasqyrave financiare vjetore dhe kuartale të prezantuara në bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, bilancin e rrjedhës së parasë, treguesit kryesorë të performancës ekonomike, si profitabiliteti, likuiditeti, solventiteti, risku dhe bankroti potencial, do të bindin investitorët aktualë dhe të ardhshëm të investojnë në kompani dhe të verifikojnë investimet e tyre nëpërmjet vlerës së tregut të akcioneve të tyre.

- **Bankieria tregtare dhe e korporatave**

Lënda synon të pajisë studentët me aftësitë themelore për një karrierë në bankën tregtare. Lënda është krijuar për të përgatitur bankierë tregtarë, analistë kredie dhe kontrata se si të menaxhojmë produktet dhe shërbimet bankare, duke i identifikuar mundësitë dhe duke i menaxhuar rreziqet e përfshira në proces.

- **Ekonometria**

Qëllimi i lëndës është që të ju mundëson studentëve që të zhvillojnë kuptimin e ekonometrisë në një nivel që do t'i pajisë ata me të kuptuarit dhe vlerësimin e analizës më të zbatuar të të dhënave ndër-sektoriale dhe të jenë në gjendje të ndërmarrin vetë një analizë të tillë. Më konkretisht qëllimet e kësaj lënde janë: - të zhvillojnë një kuptim të përdorimit të analizës së regresionit dhe teknikave përkatëse për vlerësimin e marrëdhënieve ekonomike dhe testimin e teorive ekonomike; - ti aftësojë studentët për të lexuar dhe vlerësuar punime empirike në revista profesionale; - të ofrojë përvojë praktike të përdorimit të programeve kryesore të regresionit (STATA 16) për të gjeneruar modele ekonomike.

- **Kontabiliteti i aplikuar**

Lënda ka për qëllim t'i zhvillojë studentët në përdorimin e softuerit kompjuterik dedikuar udhëheqjes së kontabilitetit financiar të mikro subjekteve të vogla dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë. Kjo lëndë ka për qëllim të zhvillojë aftësi të veçanta për zbatimin e duhur të njohurive teorike të kontabilitetit financiar nëpërmjet softuerit kompjuterik kontabël në përputhje me ligjin për kontabilitet në fuqi në R. Maqedonisë, si dhe standardet e kontabilitetit (SNK, SNR). Lënda, kontabiliteti financiar aplikativ do t'i aftësojë studentët të përgatisin të gjitha dokumentat materiale dhe financiare të nevojshme të subjekteve afariste, që do mundëson përpilimin e shpejtë të raporteve financiare dhe finalizimit të llogarive vjetore për nevojat e SHT, si dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike (DAP) dhe Regjistrat Qendror të RM (RQRM). Studentët, me këtë lëndë do të fitojnë shkathtësi dhe mundësi të reja duke lëvizur një hap më tej drejtë vetëpunësimit si kontabilist ose të punësohet në ndonjë zyrë të Kontabilistëve të certifikuar në vend. Arritja e këtyre objektivave do t'i rrisin atributet e studentëve duke i bërë ato me një vetëbesim më të lartë dhe më konkurrues në tregun e punës.

- **Revizioni**

Lënda është përpiluar që tu ofron studentëve kuptimin bazë për aspektet konceptuale teorike dhe praktike që lidhen me auditimin. Krijimi i programit mësimor është inspiruar që tu mundëson studentëve që të rumbullakojnë dijen e përvetësuar nga fusha e kontabilitetit dhe më tej të vazhdojnë në profesionin e auditimit. Qëllimi kryesor i lëndës është të demonstroi problemet kyçe me të cilat ballafaqohet profesioni i auditimit në rrafsh ndërkombëtar dhe në vend. Lënda, është koncipuar duke përdorur një qasje që realizohet hap pas hapi në kuadër të procesit të auditimit nga faza fillestare e që lidhet me negociimin e angazhimit, respektivisht nga planifikimi i auditimit dhe njohja e klientit, përmes planifikimit të aktiviteteve dhe realizimin e procedurave audituese deri në fazën finale e që është formimi i opinionit, përpilimi dhe raportimi nga realizimi i auditimit.

- **Menaxhimi i investimeve**

Lënda ka për qëllim të pajisë studentët me një fond të përshtatshëm të njohurive teorike dhe aftësive praktike në fushën e investimeve dhe vendimmarrjes investive midis subjekteve afariste në vend dhe në botën moderne. Lënda synon të afrojë teorinë dhe metodat më moderne të menaxhimit të projekteve dhe proceseve investive, dokumentimin

e tyre si dhe matjen e efikasitetit dhe efektivitetit të tyre. Studentët nga kjo lëndë do të mund të njohin dhe analizojnë investimet në mikro dhe makro plan; të përcaktojnë motivet dhe faktorët e mundshëm për investime; të planifikojnë projekte investive dhe të menaxhojnë proceset e investimeve; të përcaktojnë nivelin e rrezikut të investimit; të studiojnë dhe zbatojnë kriteret standarde dhe moderne të buxhetimit të kapitalit për pranimin ose përzgjedhjen e projektit më efikas investiv; të rrisin vetëbesimin e tyre, si dhe motivimin drejt njohurive të reja shkencore dhe përvojave praktike që do ju ndihmonin atyre në vetë punësimin eventual, ose si punonjës në ndonjë shoqëri ose bankë tregtare.

- **Anaitikë biznesi dhe modelim**

Lënda përqendrohet në procesin e transformimit të të dhënave në informacione për zgjidhjen e problemeve të biznesit në botën reale. Lënda, ka një qasje fazore në gjenerimin e njohurive: së pari, mësohet analitika përshkuese ku përdoret analitika vizuale për të karakterizuar të dhënat; së dyti, mësohet analitika rekomanduese që përqendrohet në strategjitë optimale që "duhet" të ndërmerren në të ardhmen; së treti, mësohet analitika parashikuese që përqendrohet në përdorimin e algoritmeve për parashikimin e të ardhmes në bazë të dhënave historike. Temat përfshijnë: eksplorimin e të dhënave, përgatitjen e të dhënave, optimizimin jolinear, etj.

- **Metodologjia e hulumtimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri dhe të kuptuarit e teorive të ndryshme shkencore dhe metodologjive. Fillimisht studentëve do t'u shpjegohen konceptet themelore dhe përkufizimet teorike dhe mostrat e të gjitha metodave ekzistuese të hulumtimit, hipoteza të drejtpërdrejta dhe indirekte, variablat, vlefshmëria e rezultateve, BIAS-i dhe paragjykimet dhe cilësive shkencore dhe metodologjive sasiore të kërkimit dhe qasjet e tjera metodologjike. Për çdo kapitull studentët do të kryejnë edhe detyra praktike. Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje: ta dinë dhe ta kuptojnë rëndësinë e koncepteve themelore shkencore; t'i mësojnë teknikat për hulumtim dhe kërkim efikas të informacionit dhe qasje efikase në informacione dhe literaturë relevante; t'i identifikojnë, t'i përshkruajnë dhe t'i formulojnë problemet shkencore; të bëjnë një zgjedhje të kujdeshme të qasjeve alternative kërkimore, të përshkruajnë me kujdes; të krahasojnë dhe të shpjegojnë avantazhet dhe disavantazhet e metodave të ndryshme shkencore për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në kërkime sasiore dhe cilësore; t'i aplikojnë metodat themelore shkencore për të analizuar të dhënat sasiore dhe cilësore; të sigurojnë korniza teorike themelore mbi të cilat do të ndërtohen kërkimet; t'i shqyrtojnë ato dhe të bëjnë një vlerësim të publikimeve teknike dhe atyre shkencore.

- **Menaxhimi i projekteve**

Qëllimi lëndës që të inkuadrohen studentët në botën e projekteve moderne dhe t'i ballafaqojë ata me mundësitë dhe me sfidat e jetës reale ekonomike në krijimin e projekteve të përshtatshme për nevojat reale. Qëllimet specifike të lëndës janë: si të përcaktohet një projekt i caktuar (duke përdorur disa faza) dhe të theksohet roli i rëndësishëm i menaxherit të projektit (të kuptohen nevoja, fusha e veprimit, aktivitetet për implementim, kompleksiteti i dizajnit modern, etj.). Studentët, duhet të trajnohen se si të aplikojnë mjete dhe teknika moderne të menaxhmentit modern të projektimit me rastin e transformimit të nevojës ose të idesë krijuese në një projekt real e të dokumentuar, i cili do të bëjë të jenë më inventivë për vete dhe më kompetitivë në tregun më konkurrues të punës.

- **Financa ndërkombëtare**

Kjo lëndë mbulon dimensionin ndërkombëtar të investimeve dhe financave të korporatave. Zhvillon strategji për investime ndërkombëtare, duke përfshirë mbrojtjen e rrezikut të kursit të këmbimit, përshtatjen ndaj preferencave të klientit dhe monedhat vendase, vlerësimin e performancës, vlerësimin e ekspozimit të një korporate ndaj rrezikut real të kursit të këmbimit, strategjitë për të mbrojtur rrezikun ose për tu rregulluar dinamikisht ndaj goditjeve dhe arsytet për një korporatë mbrojtje. Gjithashtu, mbulon buxhetimin ndërkombëtar të kapitalit, çmimet shumëkombëshe të transferimit dhe menaxhimin ndërkombëtar të parave të gatshme.

- **Ekonomia e aplikuar**

Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të studiojnë konceptet shumë të rëndësishme dhe përdorimin e teknikave analitike në ekonominë e avancuar. Kjo lëndë do t'ju mundësojë studentëve që të përfitojnë njohuri nga teoria dhe metodologjia ekonomike, si dhe aplikimi i tyre në observimin, mendimin kritik dhe analizën e fenomeneve ekonomike. Lënda, do të mësohet në dy pjesë: mikroekonomia dhe makroekonomia e avancuar. Në mikroekonominë e avancuar do të mësohen aspektet teorike të mekanizmit të tregut dhe konkurrenca e plotë dhe jo e plotë, si dhe aplikimi i saj praktik, kurse në makroekonominë e avancuar, do të mësohen aspektet teorike të ekonomisë si tërësi në afat të shkurtër dhe në afat të gjatë, si dhe aplikimi i njohurive në praktikë.

- **Punimi i magjistraturës**

Ky modul u mundëson studentëve që të transferojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre për kërkime dhe për të bërë detyrën më të ndërlikuar - Punimin e Magjistraturës. Moduli synon të jetë plotësisht praktik dhe studentët t'i fitojnë njohuritë e nevojshme, por edhe aftësitë dhe shkathtësitë që t'i qasen shkrimit të punimit. Moduli ka një rezultat kthyes - t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë punimin e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me një efikasitet maksimal. Lënda ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe stilit të shkrimit të punimit, duke mbajtur llogari për ndalesën e shërbimit me mjete të palejuara, siç janë: plagjiatura dhe cenimi i të drejtave të autorit, që janë të ndaluara me Statutin e UEJL-së.

Lëndë zgjedhore

• Hulumtimet e tregut

Qëllimi i lëndës është që studentët t'i kuptojnë marrëdhëniet në mes të hulumtimit të tregut dhe vendimmarrjes, duke u njohur me proceset që shfrytëzohen në formulimin dhe zbatimin e hulumtimit të tregut. Gjithashtu, studentët do t'i kuptojnë dhe kushtet e tregut në të cilat realizohet dhe zbatohet hulumtimi, duke përfshirë edhe metodologjinë e përdorur në analizën e tregjeve. Do të analizohen teknikat dhe metodat sasiore dhe cilësore që janë në dispozicion në hulumtimin e tregut, duke përfshirë zbatueshmërinë e kufizimet tyre.

• Teoria e lojës dhe strategjia e biznesit

Teoria e lojërave, një mjet tradicional për ekonomistët akademikë, është bërë gjithnjë e më popullore në botën e biznesit dhe është një mjet thelbësor i konsulentëve ekonomikë. Një degë e Ekonomisë së Biznesit dhe Politikës Publike duhet të ketë më shumë sesa një njohuri rudimentare të Teorisë së Lojërave. Vendimet menaxheriale nuk janë statike dhe nuk mund të merren të veçuara. Një menaxher duhet të marrë parasysh dhe të reagojë ndaj "lëvizjeve" të firmave rivale, qeverisë, dhe vartësve dhe eprorëve të tij ose të saj brenda kompanisë. Teoria e lojërave është krijuar për studimin e këtyre llojeve të bashkëveprimeve. Qëllimi përfundimtar i lëndës është të forconi aftësinë tuaj për të menduar strategjikisht në situata biznesi, sesa t'ju mësojë fakte ose teori. Për të arritur këtë qëllim, ne përsërisim midis teorisë dhe praktikës. Ne përdorim si studime zyrtare të rastit ashtu edhe shembuj të botës reale për të mprehur aftësitë tona të të menduarit strategjik.

• E-tregtia

Qëllimet e lëndës janë t'i njoftojë studentët me konceptet themelore të biznosit elektronik. Në këtë lëndë, studentët do të kenë mundësi të mësojnë për historinë e E-Tregtisë, modelet e biznesit për e-tregti, sistemet e online pagesave, online marketingun. Studentët, gjithashtu do të kenë mundësi të mësojnë për aspektet teknologjike të e-tregtisë, si serverët, softuerët, teknologjitë e Internetit dhe sigurinë. Si pjesë e lëndës studentët do të kenë edhe projekt ku do të zbatojnë konceptet teorike në praktikë, duke krijuar shitore elektronike, duke krijuar kampanja marketingu online, si dhe implementimin e biznes modelit tyre në praktikë.

• Financat e patundshmërive dhe analiza e investimeve

Kjo lëndë është një hyrje në konceptet, parimet, metodat analitike dhe mjetet më themelore të përdorura për të bërë investime dhe vendime financiare në lidhje me pasuritë e paluajtshme. Kjo lëndë, do të përqëndrohet në ndërtimin e njohurive nga pikëpamja mikroekonomike, dmth. do të zbatohet për pasuri të paluajtshme individuale.

• Ndërmarrje e qëndrueshme

Kjo lëndë i diskuton sfidat mjedisore dhe sociale që lindin si rezultat i mënyrës se si ndërveprojnë kompanitë me mjedisin e tyre natyror. Nga pikëpamja menaxheriale, analizohen implikimet kombëtare dhe ndërkombëtare të biznesit dhe reagimit të qeverisë ndaj këtyre sfidave. A mund të kontribuojnë bizneset për të ndryshuar për një të ardhme më të qëndrueshme? Sfidat e miratimit të strategjive të qëndrueshmërisë nga ndërmarrjet janë konsideruar dhe studentëve u mundësohet që të analizojnë në mënyrë kritike dhe të komunikojnë rezultatet e analizave të bëra.

• Lidërshipi, puna në ekip dhe diversiteti

Në këtë lëndë, studentët zhvillojnë një "set mjetesh" të sjelljeve të udhëheqjes për t'u përdorur në një larmi situatash kur ata që punojnë me dhe / ose për ta duhet të motivohen drejt një të mire të përbashkët, veçanërisht kur ajo punë përfshin përdorimin e ekipeve të përbëra të individëve të ndryshëm.

• Sistemet e informacionit të kontabilitetit

Kjo lëndë, merr një qasje integruese për të treguar se si aplikacionet e kontabilitetit janë në thelb të sistemeve të ndërmarrjeve të çdo organizate pasi ato janë jetike për menaxhimin dhe informimin e vendimmarrjes. Ai përgatit llogaritarin e ardhshëm ose analistin e biznesit për të kuptuar se si praktikisht çdo sistem i ndërmarrjes shkëmben të dhëna me një sistem të kontabilitetit dhe se sistemet e tilla mbështeten si burim i së vërtetës për raportimin dhe pajtueshmërinë.

- **Negociatat për zgjidhje të konflikteve dhe ndryshime udhëheqëse**

Një eksplorim sesi temat e negociatave, zgjidhja e konflikteve dhe ndryshimi kryesor mund të zbatohen në mjediset profesionale dinamike dhe të globalizuara. Studentët, do të bëhen vendimmarrës më të mençur dhe më të zhytur në mendime; zgjidhës më kompetentë të problemeve; udhëheqës më të guximshëm, më pak të rrezikshëm ndaj njerëzve; dhe komunikues më efektivë, bindës.

- **Parimet e financave ndërkombëtare**

Kjo lëndë mbulon dimensionin ndërkombëtar të investimeve dhe financave të korporatave. Zhvillon strategji për investime ndërkombëtare, duke përfshirë mbrojtjen e rrezikut të kursit të këmbimit, përshtatjen ndaj preferencave të klientit dhe monedhat vendase, vlerësimin e performancës, vlerësimin e ekspozimit të një korporate ndaj rrezikut real të kursit të këmbimit, strategjitë për të mbrojtur rrezikun ose për tu rregulluar dinamikisht ndaj goditjeve dhe arsytet për një korporatë mbrojtje Gjithashtu mbulon buxhetimin ndërkombëtar të kapitalit, çmimet shumëkombëshe të transferimit dhe menaxhimin ndërkombëtar të parave të gatshme.

- **Strategjia financiare dhe ristrukturimi i korporatave**

Kjo lëndë ofron një ekzaminim se si strategjitë e korporatave dhe ato financiare mund të çojnë në krijimin, mirëmbajtjen, transferimin dhe shkatërrimin e vlerës së aksionarëve. Temat e përfshira përfshijnë vlerësimin e strategjive alternative, komunikimin efektiv të strategjive në tregjet financiare dhe përafrimin e stimujve të menaxherëve me ato të aksionerëve. Është zhvilluar dhe zbatuar një kornizë për vlerësimin e bashkimeve, blerjeve dhe zhveshjeve dhe aranzhimeve të tjera të financimit të përbashkët.

- **Standarde ndërkombëtare të kontabilitetit**

Studentët, do të fillojnë duke shqyrtuar elementet dhe konceptet themelore të pasqyrave financiare, terminologjinë e kontabilitetit dhe mënyrën se si pasqyrat financiare lidhen së bashku. Pastaj, ata do të marrin në konsideratë evolucionin e kornizës rregullatore ndërkombëtare për raportimin financiar. Moduli do të prezantojë kontabilitetin në grup; kontabilizimi i taksave; kontabilizimi i pronave, impianteve, pajisjeve dhe zhvlerësimit të pasurive dhe llogaritjen e jo-materialeve plus inventarëve. Studentët, gjithashtu, do të praktikojnë dhe rishikojnë aplikimet e analizës së pasqyrave financiare dhe llogaritjet e fitimeve për aksione. Për më tepër, pjesëmarrësit do të studiojnë rolin e udhëzimeve për qeverisjen e korporatave dhe etikën e biznesit në biznesin modern.

- **Udhëheqja me proceset e biznesit**

Për të maksimizuar krijimin e vlerës, organizatat duhet të analizojnë, dokumentojnë dhe vlerësojnë me kujdes efikasitetin dhe efektivitetin e proceseve të tyre të biznesit. Me një fokus në bazat e menaxhimit të procesit të biznesit, qëllimi i kësaj lënde është të mësojë se si përdoret teknologjia e informacionit për të mundur dhe menaxhuar proceset e biznesit. Tri fushat kryesore të lëndës janë shkëmbimi i të dhënave të ndërmarrjes, sistemet e ndërmarrjeve dhe menaxhimi dhe analiza e procesit.

- **Financat kuantitative**

Lënda siguron teknika ekonometrike, të tilla si analiza e serive kohore, të nevojshme për të analizuar çështjet teorike dhe empirike në financa. Po ashtu, siguron aplikime në çmimet e pronës (aseteve), në investimet, analizën dhe menaxhimin e rrezikut, mikrostrukturën e tregut dhe në parashikimin e kthimit.

- **Biznesi digjital**

Ndërmarrja e biznesit digjital, krijimi i modeleve të reja të biznesit të arritura nga turbullira e botës digjitale dhe fizike, sillen rreth teknologjive që e bëjnë informacionin të përdorshëm dhe të lëvizshëm. Kjo lëndë përqendrohet në ekosistemin digjital, bashkëveprimin midis botës fizike dhe asaj digjitale, për të eksploruar trendet digjitale dhe risitë për bizneset. Raportet dhe diskutimet e industrisë përqendrohen në nxjerrjen e vlerës nga platformat digjitale për të adresuar strategjitë e biznesit. Temat përfshijnë: kornizat e modelimit të ndërmarrjeve, përdorimin e raporteve të industrisë dixhitale të teknologjisë në krijimin e vlerës së biznesit, platformat dhe ndërfaqet e sistemit të ndërmarrjeve dhe kornizën e menaxhimit të projektit “Cikli i Jetës për Zhvillimin e Softuerit”.

- **Kontabilitetit kombëtar dhe kontabilitetit i organizatave jo-fitimprurëse**

Lënda do t'u mundësojë studentëve të përfitojnë njohuri për rolin dhe organizimin e sistemit kontabël në sektorin publik. Në këtë drejtim vëmendje të veçantë u kushtohet parimeve bazë të kontabilitetit shtetëror, raportimit financiar shtetëror, kontabilitetit buxhetor dhe fondeve, përcaktimit të shpenzimeve dhe të ardhurave në entitetet shtetërore dhe jofitimprurëse, kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse, revizionit të sektorit publik. Përmes përvetësimit të kësaj lënde studentët do të mund të: përpilojnë evidencë kualitative kontabël tek organizatat shtetërore dhe jofitimprurëse; t'i zbatojnë standardet dhe kodeksin etik ndërkombëtar të kontabilitetit dhe revizionit në sektorin publik; të sigurojnë të dhëna dhe informacione për kontabilitetin buxhetor dhe të fondeve; të zhvillojnë aftësinë për raportim financiar shtetëror përmes përpilimit të raporteve përkatëse financiare.

- **Menaxhimi i riskut në bankieri dhe rregullativa**

Kjo lëndë ofron një analizë të hollësishme të kontratave të derivateve dhe përdorimin e tyre në strategjitë e menaxhimit të rrezikut. Ndërsa teknologjia përmirësohet dhe bankat bëhen më inovative, ato do të jenë në gjendje të izolojnë dhe shpërthejnë më shumë lloje të ndryshme të rrezikut që më pas mund të kontrollohen dhe menaxhohen. Në këtë kohë, menaxhimi i rrezikut është një fushë e re në bankë, por po zhvillohet shumë shpejt. Kjo lëndë do të përbëhet nga dy pjesë kryesore. Pjesa e parë e temës përqendrohet në blloqet ndërtimore të derivateve (domethënë të ardhmet e ardhshme, transferimet, këmbimet dhe opsionet) dhe faktorët që përcaktojnë vlerën e këtyre letrave me vlerë. Pjesa e dytë përqendrohet në rëndësinë dhe zbatimin e strategjive të menaxhimit të rrezikut.

- **Çmimi i asetëve dhe vlerësimi i letrave me vlerë**

Kjo lëndë sasiore është për studentët e financës që dëshirojnë të mësojnë teknika të ndryshme analizash dhe vlerësime të përdorura nga investitorët, sipërmarrësit, bankierët dhe të tjerë që merren me vlerësimin e borxhit ose kapitalit të kompanive të vogla, të mesme dhe të mëdha publike dhe private. Së pari, vlera në kohë e parasë dhe analiza e pasqyrave financiare do të rishikohet për t'i përgatitur studentët për të vlerësuar aksionet dhe obligacionet. Më pas i drejtohem vlerësimit të kapitalit, d.m.th., vlerësimit të aksioneve. Studentët do të mësojnë gjithashtu rreth Modelit të Çmimeve të Aseteve Kapitale (CAPM). Studentët do të shqyrtojnë efektet e levës dhe strukturës së kapitalit. Studentët do të vlerësojnë gjithashtu obligacionet. Ata do të mësojnë rreth Altman's Z-score (duke përdorur analizën diskriminuese) për të vlerësuar gjasat e mospagimit. Për më tepër, do të marrin në konsideratë lakoren e kthimeve dhe strukturën kohore të normave të interesit dhe do të mësojnë se si të vlerësojnë normat e ardhshme dhe të përdorin normat e ardhshme për të vlerësuar obligacionet dhe/ose të vlerësojnë normat e ardhshme. Moduli do të përfundojë me një studim të ndjeshmërisë së çmimit të obligacioneve ndaj ndryshimeve të normave të interesit dhe konceptit të kohëzgjatjes.

- **Ueb-i dhe analitika e mediave sociale**

Mediat sociale ofrojnë një mori të dhënash që mund të ndihmojnë organizatat të kuptojnë më mirë dhe të ndërtojnë marrëdhënie me publikun e tyre. Në këtë lëndë, studentët mësojnë se si të përdorin të dhënat e mediave sociale për të fituar njohuri për një organizatë dhe audiencën e saj, të bëjnë rekomandime që mund të zbatohen për të dhënat dhe të mësojnë rreth strategjisë së mediave sociale. Studentët, do të fitojnë përvojë praktike për analiza amtare, duke përdorur mjete matëse, duke zhvilluar plane për vlerësimin, ndërtimin dhe prezantimin e raporteve analitike të mediave sociale. Aplikacionet në botën reale do t'ju ndihmojnë të ndërtoni një portofol të fuqishëm që tregon analizat dhe vlerësimet tuaja të mediave sociale.

- **Menaxhimi i përgjithshëm i cilësisë dhe performancës**

Qëllimi i kësaj lënde është ta nxjerrë në pah rëndësinë e teknikave të MTP-së, rëndësinë e tyre, si dhe anët pozitive të përdorimit të tyre në mënyrë me qëllim që në të ardhmen e afërt ta shohim një pasqyrë krejtësisht të re të kompanitë në RMV.

- **Ekonomia monetare**

Kjo lëndë e eksploron rolin që luajnë paraja, tregjet dhe institucionet financiare, bankat qendrore dhe qeveritë në ekonominë tonë. Fillohet me një pasqyrë të rolit dhe rëndësisë së institucioneve financiare dhe tregjeve financiare. Pjesa e dytë e lëndës fokusohet në funksionet dhe rëndësinë e parasë duke përdorur modele të thjeshta të parasë dhe një pasqyrë të politikës monetare dhe bankës qendrore me fokus të veçantë në BPRM. Pjesa e tretë e lëndës i kushtohet studimit të rëndësisë dhe rolit të bankave në sistemin tonë financiar. Më tej, vazhdohet me studimin e krizave financiare, me fokus të veçantë në krizat e fundit financiare në SHBA dhe krizën e borxhit sovran në Evropë. Lënda zhvillon një sërë kornizash teorike për analizën e përcaktuesve të nivelit të çmimeve dhe normës së inflacionit, duke përfshirë ato në të cilat çrregullimet monetare kanë efekte reale, domethënë ato në të cilat paraja mund të jetë jo neutrale. Më pas, kornizat teorike përdoren si bazë për diskutimin e marrëdhënies midis rritjes së parasë dhe inflacionit, politikës së stabilizimit monetar, politikës së kursit të këmbimit dhe ndërveprimit midis politikës monetare dhe asaj fiskale.